

Gjuajtja me armë zjarri në Gjakovë, viktima thotë se u sulmua nga ish-dhëndërri

LAJME



30/12/2023 09:10



Një person në qytetin e Gjakovës, dje në orën 18:20, është qëlluar nga një tjetër me armë zjarri.

Rasti ka ndodhur në rrugën "Yll Morina", kurse atë e ka konfirmuar për lajmi.net zëdhënësi Sheremet Elezaj.

Viktima i ka thënë policëve hetues në Gjakovë se është ish-dhëndërr i atit që e ka gjuajtur me armë.

Personi i mbetur i lënduar nga plumbi po trajtohet në QKUK kurse i dyshuari vazhdon të mbetet në arrati, shkruan lajmi.net.

E policia ka gjetur dhe konfiskuar një gëzhjë të kalibrit 7.62 mm.

"Viktima mashkull kosovar ka raportuar se është sulmuar me armë zjarri nga i dyshuari mashkull kosovar (ish-dhëndërr i tij). Në vendin e ngjarjes kanë dalë njësitë përkatëse ku kanë gjetur dhe konfiskuar një gëzhjë të kalibrit 7.62 mm. Viktima ka pësuar lëndime trupore dhe i njëjti është dërguar për tretman mjekësor në QKUK-Prishtinë. Nuk raportohet për të arrestuar", thuhet në njoftimin e PK-së.

Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LupaMedia




Artikuj të ngjashëm



December 31, 2023

Heqja e vizave bën të vetën: Mbi 287 mijë pasaporta u lëshuan për një vit




December 31, 2023

Ofroi rryshfet në kufi – Arrestohet i dyshuari



December 31, 2023

Mjegulla: Policia apelon për kujdes gjatë vozitjes



December 31, 2023

Kanosen e malltretohen dy gra: Një në Lipjan dhe tjetra në Podujevë



December 31, 2023

Policia del me detaje për shkëmbimin me armë zjarri dje në veri



December 31, 2023

Puna e Qeverisë gjatë 2023: Opozita me kritika të shumta



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrja nr. 5

RRJETET SOCIALE



Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information